



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE "RTV ROZAFI" SH. A.

Personat te cilet jane renditur ne Nenin 1 te ketij Akti Themelimi, pasi biseduan ndermjet tyre dhe rane dakord qe te krijojne nje Shoqeri Anonime, hartojne dhe neneshkruajne kete Akt Themelimi, me permbajtjen si me poshte:

Neni 1 Aksioneret

Aksioneret e Shoqerise "RTV ROZAFI" Sh. A. jane personat e meposhtem:

1. **Anton Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1966 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty.
2. **Eduard Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1968 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty.
3. **Çesk Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1970 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty.
4. **Lek Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1972 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty.

Neni 2 Emertimi

Emertimi i Shoqerise do te jete "RTV ROZAFI" Sh.A.

Neni 3 Selia

Shoqeria do ta kete seline ne Shkoder, ne adresen: Ish-fototeka "Marubi", prane Bashkise.



Neni 4 Kapitali

Kapitali i Shoqerise "RTV ROZAFA" Sh.A. eshte 2.000.000 leke dhe eshte i ndare sipas listes se meposhtme:

- | | |
|-----------------|--|
| 1. Anton Kokaj | kontribuon me 400.000 (katerqind mije) leke. |
| 2. Eduard Kokaj | kontribuon me 400.000 (katerqind mije) leke. |
| 3. Çesk Kokaj | kontribuon me 800.000 (teteqind mije) leke. |
| 4. Lek Kokaj | kontribuon me 400.000 (katerqind mije) leke. |

Neni 5 Objekti

Objekti i shoqerise eshte veprimtaria radiotelevizive e cila perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te çdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me çdo mjet tjeter.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pakufizuar kohe.

Neni 7 Struktura e Shoqerise

Shoqeria do te kete organet e saj :

1. Asambleja e Aksionereve.
2. Keshilli Mbikqyres.
3. Drejtori.

Rregullat e funksionimit te tyre parashikohen ne statut dhe pranohen nga aksioneret. Keshilli i pare Mbikqyres perbehet nga zoterinjte: Luigj Kokaj, Luan Borova dhe Gasper Kokaj.

Kryetar i pare i Keshillit Mbikqyres eshte zoti **Gasper Kokaj**.
Drejtori i pare eshte zoti **Gasper Marku**.



Neni 8

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Çdo mosmarrveshje eventuale palet do te perpiqen te zgjidhin me bisedime dhe nepermjet mirekuptimit. Ne qofte se me menytrat e mesiperme mosmarrveshja nuk do te zgjidhet, atehere secila nga palet mund t'i drejtohet gjykates kompetente.

Neni 9

Dispozite e fundit

Ky Akt Themelimi perpilohet ne gjuhen shqipe dhe neneshkruhet ne 4 (kater) ekzemplare origjinale, me te njejten vlere dhe ka fuqi per palet qe nga data e neneshkrimit, qe eshte sot, me _____.

AKSIONERET THEMELUES

Anton Kokaj

Eduard Kokaj

Çesk Kokaj

Lek Kokaj



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

Nr. 3323 Rep.

Nr. 396 Kol.

Tiranë, më 02 . 11 . 2000.

VERTETIM


Sot, në Tiranë, në datën 02 . 11 . 2000, ditë e Enjte, përpara meje Noterit E. Hoxha, i Dhomës së Notereve Tirane, u paraqitën personat në listë:

1. Z. Anton Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1966 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaporte Nr.1158028.
1. Z. Eduard Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1968 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaporte Nr.0154987.
2. Z. Çesk Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1970 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaporte Nr.1556828.
3. Z. Lek Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1972 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaporte Nr.0232902.

Personat e mësipërm janë madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar dhe për identitetin e tyre u sigurova nga dokumentet identifikues që ata mbajnë. Pasi unë, Noteri, ua lexova dhe ua shpjegova Aktin e Themelimit bashkëngjitur këtij vërtetimi, ata më deklaruan se i kuptojnë, i pranojnë dhe se i kanë hartuar ato në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan para meje rregullisht, gjë të cilën, unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERI

NOTERE
ENKELEIDA HOXHA
Tiranë Tel 713 26





STATUT

I SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE "RTV ROZAFI" SH. A.

Ne mbeshetje te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare", te Ligjit Nr.8080, date 01.03.1996, "Per letrat me vlere" dhe te ligjit Nr.8410, date 30.09.1998 "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise", aksioneret:

1. **Anton Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1966 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty;
2. **Eduard Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1968 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty;
3. **Çesk Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1970 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty;
4. **Lek Kokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Luigjit, i lindur me 1972 ne Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty;

duke neneshkruar edhe Aktin e Themelimit, me _____, kane themeluar Shoqerine Anonime pa oferte publike, te emertuar "RTV ROZAFI" Sh. A., e cila do te funksionoje sipas percaktimeve te ketij Statuti, me permbajtjen e meposhteme :

I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Personaliteti juridik

Shoqeria "RTV ROZAFI" Sh.A. fiton personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 2

Dokumentacioni

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, statutin dhe aktin e themelimit.

NOTER
TIRANE

Neni 3
Emri, selia dhe shtrirja e Shoqerise

Emertimi i Shoqerise do te jete "RTV ROZAFa" Sh.A.

Shoqeria do ta kete seline ne Shkoder, ne adresen: Ish-fototeka "Marubi", prane Bashkise.

Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se zakonshme.

Neni 4
Objekti

Objekti i shoqerise eshte veprimtaria radiotelevizive e cila perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjetet.

Neni 5
Kapitali themeltar

Shoqeria Anonime "RTV ROZAFa" Sh.A. ka nje kapital themeltar prej 2.000.000 (dymilion) leke, duke kontribuar secili aksioner si me poshte:



- | | |
|-----------------|---|
| 1. Anton Kokaj | 400.000 (katerqind mije) leke ose 20 % e kapitalit. |
| 2. Eduard Kokaj | 400.000 (katerqind mije) leke ose 20 % e kapitalit. |
| 3. Çesk Kokaj | 800.000 (teteqind mije) leke ose 40 % te kapitalit. |
| 4. Lek Kokaj | 400.000 (katerqind mije) leke ose 20 % e kapitalit. |

Kapitali e shoqerise eshte ndare ne 2.000(dy mije) aksione secili me nje vlere mominale 1.000 (njemije)leke. Pronesia e aksioneve eshte:

- | | |
|-----------------|-----------------------------|
| 1. Anton Kokaj | -- 400 (katerqind) aksione. |
| 2. Eduard Kokaj | -- 400 katerqind) aksione. |
| 3. Çesk Kokaj | -- 800 (teteqind) aksione. |
| 4. Lek Kokaj | -- 400 (katerqind) aksione. |

Neni 6
Afati i veprimtarise

Shoqeria anonime "RTV ROZAFa" Sh.A. e ushtron veprimtarine e saj pa afat te kufizuar.



UTER
IRANE

**Neni 7
Transferimi i aksioneve**

Aksionet e shoqerise jane te transferueshme. Transferimi i pronesise se aksioneve nominative behet mbasi te jete marre miratimi me shkrim edhe nga Keshilli Mbikeqyres. Perparesia ne transferimin e aksioneve u takon aksionereve te tjere te shoqerise, sipas radhes se paraqitjes se ofertave, te cilat vleresohen nga Keshilli Mbikeqyres. Aksionet mund t'i transferohen cdo personi fizik apo juridik, shqiptar ose te huaj. Keshillit Mbikeqyres duhet t'i paraqitet nje kerkese ku percaktohet identiteti i plote i personit fizik ose juridik qe i transferohet pronesia, numri i aksioneve qe parashikon transferimi i pronesise dhe cmimi i ofruar.

II

ORGANET, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

**Neni 8
Asambleja e aksionereve**

Mbledhja e Asamblese thirret nga Keshilli Mbikeqyres ose nga drejtori. Gjithashtu ajo mund te thirret nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga aksioneret qe zoterojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar. Njoftimi per Mbledhjen e Asamblese behet te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes, duke parashtruar rendin e dites dhe dokumentacionin e nevojshem.

Votat e aksionereve kane peshe proporcionale me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Cdo aksioner jep te drejten e nje vote. Cdo aksioner mund te perfaqesohet ne Asamble nepermjet nje aksioneri tjetere ose nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene keta te autorizuar me prokure. Prokura mund te jete e vlefshme per nje mbledhje, per nje numer te caktuar mbledhjesh, per nje numer te pakufizuar mbledhjesh, per nje kohe te caktuar ose per nje kohe te pacaktuar.

**Neni 9
Asambleja e zakoneshme**

Asambleja e zakoneshme merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem ne qofte se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 1/4 e aksioneve me te drejte vote. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet, ne te dyten nuk kerkohej asnje lloj quorumi. Asambleja e zakoneshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Mbledhjet e asamblese se zakoneshme behen te pakten nje here ne vit, brenda gjashte muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar.

Mbledhjet e Asamblese verbalizohen dhe materialet ruhen ne arkive.

Lek Kotsaj

NOTER
TIRANE

Vendimet e Asamblese se zakonshme mund te jene edhe qarkulluese. Per te realizuar kete lloj vendimi shperndahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u mbledhur aksioneret fizikisht ne nje salle. Mbledhjet mund te realizohen dhe quhen te vlefshme edhe mepermjet videokonferences. Ne kete rast mbledhjet regjistrohen dhe shiriti magnetik autentik ruhet ne arkive. Asambleja e zakonshme ka keto kompetenca:

- Emeron Keshillin Mbikeqyres dhe Kryetarin e tij.
- Percakton shperblimin e anetareve te Keshillin Mbikeqyres.
- Miraton politiken e pergjithshme te shoqerise.
- Miraton ekspertet kontabel.

Neni 10

Asambleja e jashtezakonshme

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne qofte se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe ne te dyten $\frac{1}{4}$ e aksioneve me te drejte vote. Ne mungese te ketij quorumi mbledhja e dyte e asamblese mund te shtyhet per nje date te mevoneshme, jo me te larget se dy muaj nga data e thirrjes se pare. Ajo merr vendime me nje shumice votash prej $\frac{3}{4}$ qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar. Mbledhet e Asamblese se jashtezakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen ne arkive. Asambleja e jashtezakonshme ka keto kompetenca :


- te ndryshoje statutin ne qofte se eshte e nevojshme per shkak te aktivitetit te shoqerise.
- te vendose per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit ne baze te raportit te paraqitur nga Keshilli Mbikeqyres dhe te procedurave te percaktuara ne ligj.
- te heqe te drejten e perparise se nenshkrimet, ne qofte se e sheh te arsyeshme ne rastin e zmadhimit te kapitalit
- te vendose prishjen e shoqerise ne rast te humbjeve te konstatuara ne dokumentat kontabel, sipas kushteve dhe procedurave te percaktuara ne ligj.
- te ndryshoje kompetencat e Keshillit Mbikeqyres dhe Drejtorit te Pergjithshem.


Neni 11

Keshilli Mbikeqyres

Keshilli Mbikeqyres emerohet nga asambleja e zakonshme e aksionereve çdo tre vjet. Ai perbehet nga 3 (tre) vete, nga te cilet njeri Kryetar. Anetaret e Keshilli Mbikeqyres jane te riemerueshem. Ata mund te revokohen nga asambleja e zakonshme, vetem per shkaqe te perligjura.

Mbledhja eshte e vlefshme neqoftese marrin pjese te pakten 2 anetare. Keshilli Mbikeqyres merr vendime me shumice votash. Votat e anetareve kane peshe te barabarte. Vota e kryetarit eshte vendimtare ne rast te votimit te barabarte.



OTER
TIRANE

Keshilli i pare Mbikqyres perbehet nga zoterinjte: Luigj Kokaj, Luan Borova dhe Gasper Kokaj.

Kryetar i Keshilli Mbikqyres eshte zoti **Gasper Kokaj**.

Keshilli Mbikqyres ka vulen e vet.

Keshilli Mbikqyres ben mbledhje dhe merr vendime me propozim me shkrim te Kryetarit te tij ose te Drejtorit. Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane pesona fizike ose juridike. Ne rastin kur jane pesona fizike ata nuk duhet te jene te punesuar ne shoqeri. Ne rastin kur anetar i Keshillit Mbikqyres eshte nje person juridik, ai duhet te caktoje nje perfaqesues te perhershem, i cili nuk duhet te jete i punesuar ne shoqeri. Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk duhet te bejne pjese ne keshilla te tjera mbikqyrese, ose ne organe drejtuese te shoqerive te tjera anonime qe kane lidhje me shoqerine "RTV ROZAF" dhe qe zhvillojne veprimtarine e tyre ne territorin e Republikes se Shqiperise. Nese nje ose disa vende te anetareve te Keshilli Mbikqyres mbeten bosh per shkak te vdekjes, shkarkimit ose doreheqjes, zevendesimi i tyre behet jo me vone se tre muaj. Anetari i Keshilli Mbikqyres i emeruar ne zevendesim te nje anetari tjetër, perfundon mandatin e paraardhesit.

Mbledhjet e Keshilli Mbikqyres verbalizohen dhe materialet ruhen ne arkive.



Keshilli Mbikqyres ka keto kompetenca:

- Zgjedh Drejtorin me votat e te pakten 2 anetareve.
- Shkarkon para afatit Drejtorin e Pergjithshem me votat e te pakten 2 anetareve.
- Miraton transferimin e aksioneve.
- Miraton bilancin vjetor dhe ja paraqet Asamblese se Zakonshme.
- Miraton strategjine e zhvillimit dhe projektet e reja strategjike.
- Miraton marrjen e huave afatmesme e afatgjata, dhenien e dorezanive ose garancive te tjera kur keto te fundit tejkalojne veprimtarine e zakonshme te shoqerise.
- Miraton strukturen e shoqerise dhe strukturen e masen e pagave.
- Miraton strukturen e tarifave baze te sherbimit.
- Ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrolle qe ai e i gjykon te nevojshme dhe te kerkoje te njihet me dokumentat qe ai i gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se tij.

Neni 12
Drejtori

Drejtoria e Shoqerise, ne kuptimin e ligjit "Per shoqerite tregtare", perbehet nga Drejtori. Drejtori eshte pergjegjes per drejtimin dhe mirefunksionimin e shoqerise, administrimin e pasurise dhe interesave te saj. Ai aplikon me metodat dhe menyrat qe i gjykon me te mira, me te pershtateshme dhe me efektive, per te realizuar objektivat e percaktuara nga Keshilli Mbikqyres dhe Asambleja.

Drejtori ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise. Ai i ushtron keto kompetenca brenda objektit te veprimtarise se saj.



Let Kokaj

Neni 14
Viti financiar

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht viti i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri ne 31 dhjetor.

Neni 15
Bilanci vjetor

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori, sipas struktures dhe permbajtjes se percaktuar ne planin kontabel, pregatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tremujor si dhe ate vjetor.

Ne mbylljen e cdo viti financiar, hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe rapoti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate vitit te kaluar, ku parashikohen edhe ndryshimet per te ardhmen, si dhe veprimtarite e tjera te shoqerise.

Keto dokumente i jepen ekspertit kontabel nje muaj perpara mbledhjes se asamblese se aksionereve, i cili ben komentet e veta ne nje raport te vecante.


Neni 16
Miratimi i bilancit

Raporti per gjendjen e financiare te shoqerise, i detajuar per te gjitha operacionet si dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Drejtori, ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise, i cili e miraton dhe ja paraqet Asamblese se Zakonshme te aksionereve.

Neni 17
Rezultati i vitit financiar dhe rezervat

Rezultati i vitit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit, duke perfshire ne keto te fundit edhe amortizimet, provizionet dhe taksat. Nga fitimet e vitit te pakesuara, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, hiqen te pakten 5% per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 15% te kapitalit themeltar.

Nga fitimet e vitit te pakesuara, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, shoqeria do te heqe jo me shume se 85% per krijimin e rezervave per zhvillim. Asambleja e zakonshme ne rast nevojje mund te formoje edhe fonde te tjera.



Shuma e fitimeve te mbetura pas krjimit te rezervave te krijuara me siper, parfaqeson dividendin.
Aksioneret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit te destinuar per ndarje nga Asambleja e Zakonshme, proporcionalisht me pjesemarrjet e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 18 Pergjegjesite ndaj shtetit

Shoqeria ka llogarite e saja bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet te tjera ndaj shtetit.

Neni 19 Ekspertet kontabel


Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa eksperte te autorizuar, te licensuar konform legjislacionit shqiptar, te cilet emerohen nga Asambleja e Zakonshme dhe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin. Ne çdo kohe te vitit ekspertet kontabel te autorizuar se bashku ose veç e veç bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe i gjykōjne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne ne vend te gjithë dokumentacionin e vleresuar si te dobishme ne ushtrimin e funksionit te tyre dhe ne veçanti kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces verbaleve.
Ekspertet kontabel informojne Drejtorin dhe Keshillin Mbikqyres per:


- Kontrolllet, verifikimet dhe sondazhet qe kane kryer.
- Pjeset e bilancit dhe te dokumntave te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje.
- Parregullsite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.

Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllin llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jene pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per fajin dhe nenvleftesimin e tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe kane.
Honoraret e eksperteve kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqerise. Keshilli Mbikqyres me rastin e miratimit te eksperteve miraton edhe masen e shperblimit te tyre.
Eksperti i pare kontabel i autorizuar eshte z. Ylber Berhani.

Neni 20 Likujdimi

Shperndarja e shoqerise "RTV ROZAF" Sh.A. mund te behet ne çdo kohe, kur, per shkaqe te ndryshme, ajo nuk mund te vazhdoje aktivitetin e saj. Ne kete rast ajo vihet ne likuidim.
Likujdimi behet me pajtim me dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare".
Asambleja e jashtezakonshme cakton likuidatoret duke u percaktuar edhe fuqite qe ata do te kene.





IV

RREGULLIMI I SHOQERISE

Neni 21

Ndryshimet e kapitalit themeltar

Ndryshimet e kapitalit themeltar te shoqerise, zmadhimi ose zogelimi i tij, si dhe menyra e realizimit te tyre, do te percaktohen konform dispozitave te ligjit "Per shoqerite tregtare" nr.7638 date 19.11.1992 dhe akteve tjera ligjore ne fuqi.

Neni 22

Transformimi ne shoqeri me oferte publike

Shoqeria "RTV ROZAF" Sh.A. pa oferte publike mund te transformohet ne shoqeri me oferte publike. Vendimi per kete transformim merret nga Asambleja e Jashtezakonshme.

Neni 23

E drejta e komunikimit dhe e informimit

Çdo aksioner ka te drejten e komunikimit dhe informimit te vazhdueshem. Para cdo assembleje ose konsultimi me shkrim, cdo aksioner ka te drejten e njohjes me dokumentacionin dhe te gjitha informacionet e tjera qe lidhen me problemet qe do te diskutohen ose konsultohen. Keto duhet t'i vihen ne dispozicion sipas kushteve te percaktuara ne dispozitat ligjore dhe rregulloret ne fuqi.

Neni 24

Fshehtesia e informacionit dhe konfidencialiteti

Te gjitha aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtori dhe te gjitha te punesuarit ne shoqerine "RTV ROZAF" Sh.A. jane te detyruar re ruajne fshehtesine e cdo informacioni apo te dhene ne lidhje direkte ose indirekte me shoqerine, per te cilen ata vihen ne dijeni gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre ose ne menyre te terthorte. Ata duhet te marrin te gjitha masat e nevojshme dhe te zbatojne procedurat e percaktuara per te penguar perhapjen ne cfaredolloj forme te informacionit. Te gjitha aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtori dhe te gjitha te punesuarit ne shoqerine "RTV ROZAF", pergjigjen per pasojat e demshme qe i shkaktohen shoqerise nga perhapja e paautorizuar e informacionit.



**Neni 25
Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet midis aksionereve, te punesuarve dhe personave te trete kontraktues, ne rast se zgjidhja e ceshtjes nuk arrihet me mirekuptim, ajo behet objekt i gjykates kompetente.

**Neni 26
Marredheniet me punonjesit**

Marredheniet e shoqerise me punonjesit rregullohen sipas legjislacionit te punes ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 27
Falimentimi, paaftesia ose vdekja e nje aksioneri**

Shoqeria nuk priset kur falimenton, vdes ose shfaq paaftesi njeri prej aksionereve.

**Neni 28
Vulat dhe stema**

Shoqeria ka vulen dhe stemen e vet.

**Neni 29
Rastet e paparashikuara**

Rastet e paparashikuara ne kete statut do te trajtohen duke u bazuar ne ligjin "Per shoqerite tregtare" Nr.7683 date 19.11.1992 dhe ne aktet e tjera ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 30
Gjuha dhe kopjet origjinale**

Ky statut eshte hartuar ne gjuhen shqipe, ne 4 (kater) ekzemplare origjinale dhe me fuqi te njejte.

AKSIONERET E SHOQERISE "RTV ROZAFI" SH. A.

Anton Kokaj

Eduard Kokaj

Çesk Kokaj

Lek Kokaj

REPubLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 3324 Rep.
Nr. 399 Kol.

Tiranë, më 02.11.2000.

VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën 02.11.2000, ditë e Enjte, përpara meje Noterit E. Hoxha
Dhomës së Notereve Tirane, u paraqitën personalisht:

1. Z. Anton Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1966 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaportë Nr.1158028.
1. Z. Eduard Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1968 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaportë Nr.0154987.
2. Z. Çesk Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1970 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaportë Nr.1556828.
3. Z. Lek Kokaj, i biri i Luigjit, lindur në 1972 në Bajze, Malesi e Madhe dhe banues po aty, me pasaportë Nr.0232902.

Personat e mësipërm janë madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar dhe për identitetin e tyre u sigurova nga dokumentet identifikues që ata mbajnë. Pasi unë, Noteri, ua lexova dhe ua shpjegova Statutin bashkëngjitur këtij vërtetimi, ata më deklaruan se i kuptojnë, i pranojnë dhe se i kanë hartuar ato në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan para meje rregullisht, gjë të cilën, unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERI

NOTERE
ENKELEIDA HOXHA
Tiranë Tel 713 26

